


KËSHILLI DREJTUES

VENDIM QARKULLUES

Nr. 21, datë 04.06.2021

**Për miratimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Agjencisë së Sigurimit të
Depozitave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH),
për linjën e kredisë së disponueshme
për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, pika 1, shkronja “n”, neni 52, pika 1, shkronja “nj”, të nenit 53, pika 6, shkronja “b”, të nenit 58, pika 1, shkronja “c”, të nenit 60 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 305, datë 26.05.2021 “Për miratimin në parim, të marrëveshjes së garancisë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për marrëveshjen e huasë, ndërmjet Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për linjën e kredisë për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të Vendimit Qarkullues të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 30.07.2020 “Mbi dhënien e autorizimit paraprak Drejtorit të Përgjithshëm për fillimin e negociatave dhe hartimin e projekt marrëveshjes së linjës së kredisë në gatishmëri ndërmjet Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për përmbushjen e detyrimeve ligjore të Agjencisë në rast të një ngjarjeje sigurimi”, të nenit 7, pika 6, të nenit 8, pika 2, shkronja “b” të Statutit të Agjencisë të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 5, pika 2, shkronja “c” të rregullores të Këshillit Drejtues nr. 20, datë 25.09.2017 “Për nënshkrimet e autorizuara në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të nenit 10, pika 6 dhe të nenit 18, pika 2 të rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe



KËSHILLI DREJTUES

procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të miratojë marrëveshjen e huasë ndërmjet Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për linjën e kredisë së disponueshme për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.
3. Të njoftohet Autoriteti Mbikëqyrës dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë lidhur me këtë vendim.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar